

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit: Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë

Sa i përket tenderit për Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë me nr prokurimit:626-24-8441-5-1-1

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"HARST Group" Sh.p.k.  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr 7 Marsi p.n.-Suharek  
(Adresa)

Suharekë  
(Vendi)

23000

(Kodi postar)

+38349460512  
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Sadik Ramadani  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Info@harstgroup.eu  
(Adresa elektronike)

24.10.2024  
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

21.08.2024 Njoftimi per kontratë

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

**Neni 1 i LPP-se-Qëllimi**  
**Neni 7 i LPP-se-Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**  
**Neni 28 i LPP-se-Specifikimet teknike**  
**RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Të nderuar

Pas publikimit të dosjes së tenderit : *Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë* ne si palë me interes për të aplikuar dhe ofertuar në këtë tender kemi vërejtur se ju si AK-së keni vendosur kërkesa dhe specifika skajshmërisht diskriminuese dhe ekstremisht favorizuese për një kompani të caktuar, ku në bazë të specifikave të kërkuara tek pjesa e paisjeve mund të vërhet qartë që kemi të bëjmë me favorizim absolut për një kompani, duke reduktuar konkurrencën po besojmë në vetëm një kompani.

Poashtu nëse shikojmë vetëm listën e paisjeve pa e lexuar titullin e projektit po besojmë se bindja e cilit do person do të ishte që projekti në fjalë është Ndërtimi i ndonjë Autostrade , pasi që kërkesat për paisje dhe kërkesat specifike për disa pozicione siq është Asfaltri na bëjnë më dije se këto kërkesa nuk kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së projekti por vetëm favorizimin e një ofertuesi.

Ju si AK-së keni bërë shkelje të Nenit 1 të LPP-së – Qëllimi , poashtu keni bërë shkelje të Nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku keni shkelur gjithë paragrafet e këtij Neni. Keni bërë shkelje të Nenit 28-Specifiket Teknike pasi që specifikat e hartuara teknike janë diskriminuese dhe favorizuese.

Në vazhdim gjeni Pretendimet Ankimore:

### **Pretendimi Ankimor 1:**

**9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.4 Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi Infrastrukturë rrugore), kërkohet të ketë min. 8 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar për menaxhimin e projekteve dhe të jete i pajisur me Certifikatë për siguri rrugore.**

Kjo kërkesë është plotësisht diskriminuese pasi që duke u bazuar në natyrën e kontratës e cila është ndërtim i lartë dhe punë e infrastrukturës rrugore janë minimale në krahasim me pjesët tjera të projektit , atëherë kërkesa për inxhinier të infrastrukturës rrugore sidomos me përvojë mbi 8 vite redukton konkurrencën maksimalisht pasi që e dimë se personat me këtë përvojë të punës janë të paktë pasi që ky program studimor ka qenë për shumë vite i pa akredituar në Universitetin e Prishtinës , poashtu kërkesë për certifikatë për siguri rrugore është e panevojshme pasi që objekti i kontratës është brenda kantierit dhe nuk ka kontakt me komunikacion Publik.

Kërkojmë nga Ju si AK-së që kërkesa për Inxhinier të Infrastrukturës me Përvojë 8 vite të ndryshohet në 3 vite dhe poashtu certifikata për siguri rrugore të largohet nga kërkesat e DT-së.

**Pretendimi Ankimor 2:**

**Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të DT.**

**ANEKSI 8 LISTA E PAISJEVE**

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar minimale (cope)
1.	Eskavator min 5Tonë	2 copë
2.	Eskavator 7 Tonë	1 copë
3.	Eskavator 8-10Tonë	2 copë
4.	Eskavator max 16 Tonë	3 copë
5.	Eskavator min 22 Tonë	2 copë
6.	Eskavator me gjatesi krahu 18meter mbi 30Tonë	1 copë
7.	Eskavator minimum 54,000 kg	1 copë
8.	Ngarkuese max 3 Tonë	1 copë
9.	Ngarkues 5-6 Tonë	1 copë
10.	Makine per prerjen e elementeve te Betonit	1 copë
11.	Makineri ngjeshese 70kg	1 copë
12.	Makine ngjeshese 190kg	1 copë
13.	Makine ngjeshese 430kg	1 copë
14.	Ngjeshes Cilinder 1.5-2 Tonë	1 copë
15.	Ngjeshës Cilindër 6.5-7 Tonë	1 copë
16.	Cilinder Vibrator 9-10 Tonë	1 copë
17.	Ngjeshës Cilindër 12-13 Tonë	1 copë
18.	Cilinder Gome-Gome 13-14Tonë	1 copë

19.	Cilinder toke me peshe 19-20 Tonë	1 copë
20.	Ngjeshës Cilindër minimum 25 Tonë	1 copë
21.	Cilinder vibrues me dhëmbëza min 21 Ton	1 copë
22.	Greder per rrafshim min 12 Ton	1 copë
23.	Makine per spërkatje me emulzion 1.5-2 Ton	1 copë
24.	Finisher per shtrimin e asfaltit min 19 Ton	1 copë
25.	Cilinder per asfalt heker - heker min 8 Ton	1 copë
26.	Cilinder per asfalt heker - gome min 8 ton	1 copë
27.	Cilindër per asfalt gome gome 13-15 Ton	1 copë
28.	Cilindër per asfalt hekur hekur min 4 Ton	1 copë
29.	Cilindër per afalt hekur gome min 3.5	1 copë
30.	Dumper pesha-1-2 Tonë	1 copë
31.	Dumper 2-3 Tonë	1 copë
32.	Vinç	1 copë
33.	Traktor 4x4	1 copë
34.	Kamion kipper me kran me peshe ngarkese 8-10 Tonë	1 copë
35.	Kamion Kiper me peshe ngarkese 7-8Tonë	1 copë
36.	Kamion Rende me peshe ngarkese 10-15-Tonë	1 copë
37.	Kamionet dubelkabine	2 copë
38.	Kamion Kiper me peshe ngarkese 17-19-Tonë	2 copë
39.	Pickup	2 copë
40.	Fshese per mini lopate per pastrimin e rrugeve	1 copë
41.	Sharre hidraulike per prerjen e drunjeve, asfaltit, betonit	1 copë

Pika	42.	Kompresor ajri te montuar mbi nje shasi me rrota	2 copë	6.
	43.	Makine per vendosjen e kubezave te betonit	1 copë	
	44.	Paisje(vakum) ngritese per anesore te betonit	1 copë	
	45.	Gjysme rimorkio me shenja te trafikut	1 copë	
	46.	Gjysme rimorkio min.35Tone	1 copë	
	47.	Rimorkio per bartjen e automjeteve 8-10tone	1 copë	
	48.	Rrethoja montuese per sigurimin e punishtes	25 copë	
	49.	Ngjeshese hidraulike,montuese ne eskavator	1 copë	
	50.	Motorsharre per prerjen e drunit	2 copë	
	51.	Gjenerator elektrik	1 copë	
	52.	Thithse elektrike	1 copë	
	53.	Paisje per grryrje te gletit	1 copë	
	54.	Makin per suvatim	1 copë	
	55.	Makin per ngjyrosje	1 copë	
	56.	Hillt per thyrje te betonit	1 copë	
	57.	Aparat per salldim	1 copë	
	58.	Elemente ( shalltafne)	1,000 m <sup>2</sup>	
	59.	Shtylla metalike	1,000 copë	
	60.	Skele - skelet te jen te qertifikuar sipas standartit EN 131-2:2017	3,000 m <sup>2</sup>	
	61.	Platform lift me lartesi 15 m	1 copë	

#### Eskavator me gjatesi krahu 18meter mbi 30Tonë

*Kjo kërkesë nuk është në përputhje me llojin e projektit pasi që është i panevojshëm eskavatori me këtë tonazh për këtë llojë punihste , poashtu ju lutem të na sqaroni kufizimin e krahut të bagerit 18 m' , a ka ndonjë kuptim të veçantë apo nevojë të veçantë që me ni rrotullim të arrijë gjithë sipërfaqen apo ndonjë qëllim tjetër. Po besojmë që qëllimi kryesorë i kësaj pike është kufizimi i konkurencës andaj kërkojmë që kjo paisje të largohet nga kërkesat e DT-së pasi që është plotësisht e panevojshme për këtë lloj projekti.*

**Pika 7. Eskavator minimum 54,000 kg**

*Po besojmë me njohuritë që kemi për terrenin tuaj si Komunë ju sipërfaqe malore keni të pakta ose edhe aspak dhe po besojmë kërkesa për një eskavator të këtij kapaciteti që edhe në rrugët nacionale që janë duke u punuar nuk mund ta hasni pasi që është i kapaciteti të lartë dhe i panevojshëm atëherë si munf të arsytohet kërkesa për këtë eskavator në një objekt ndërtimi të lartë.*

*Kërkojmë që kjo kërkesë të largohet nga DT pasi që është favorizuese për ofertues të caktuar.*

**Pika 8.**

9	Ngarkues 5-6 Tonë	1 copë
10	Makine per prerjen e elementeve te Betonit	1 copë
11	Makineri ngjeshese 70kg	1 copë
12	Makine ngjeshese 190kg	1 copë
13	Makine ngjeshese 430kg	1 copë
14	Ngjeshes Cilinder 1.5-2 Tonë	1 copë
15	Ngjeshës Cilindër 6.5-7 Tonë	1 copë
16	Cilinder Vibrator 9-10 Tonë	1 copë
17	Ngjeshës Cilindër 12-13 Tonë	1 copë
18	Cilinder Gome-Gome 13-14Tonë	1 copë
19	Cilinder toke me peshe 19-20 Tonë	1 copë

1.	Ngjeshës Cilindër minimum 25 Tonë	1 copë
2.	Cilinder vibrues me dhëmbëza min 21 Ton	1 copë
3.	Greder per rrafshim min 12 Ton	1 copë
4.	Makine per spërkatje me emulzion 1.5-2 Ton	1 copë

*Gjitha pasijet e lartëkërkuara ju i keni paraqitur me peshë të caktuar përshmebull 170 kg, 190 kg , ose kufizim minimal 5-6 ton , 6.5-7 tonë 1.5-2 ton , poashtu cilindri me peshë minimum mbi 25 tonë, Cilindri Vibrues me dhembëza min 21 ton dhe grederi min 12 ton janë kërkesë te panevojshme te cilat nuk pëpruthen me natyrën dhe nevojat e projekti, por kanë të vetmin qëllim favorizimin e një ofertuesi të caktuar dhe zvogëlimin e*

konkurencës , andaj kërkojmë nga ju si AK të i largoni këto kufizime dhe të kërkoen ose min ose max pasi që kufizimi i këtill paraqet diskriminim për kompanitë dhe favorizim për një kompani të caktuar , dhe kërkesa për paisjet me peshë kaq të lartë janë totalisht të panevojshme dhe në mospërputhje me llojin e punimeve që do të kryhen në këtë projekt.

Pika 9.

27	Cilindër per asfalt gome gome 13-15 Ton	1 copë
----	---	--------

30	Dumper pesha-1-2 Tonë	1 copë
31	Dumper 2-3 Tonë	1 copë

34	Kamion kipper me kran me peshe ngarkese 8-10 Tonë	1 copë
35	Kamion Kiper me peshe ngarkese 7-8Tonë	1 copë
36	Kamion Rende me peshe ngarkese 10-15-Tonë	1 copë

38	Kamion Kiper me peshe ngarkese 17-19-Tonë	2 copë
----	---	--------

47	Rimorkio per bartjen e automjeteve 8-10tone	1 copë
----	---	--------

Paisjet e kërkuar Nr. 27 ; 30 ; 31 ; 34 ; 35; 36;38; 47 janë kërkesa diskriminuese dhe paracaktuese se kush do të mund të ofertojë në këtë procedurë pasi që ky kufzim i peshave në diferenc 1 deri 2 tonë ose në raste 0.5 tonë , tregon përshtatje të specifikave për një ofertues të caktuar .

Paisja numër 40 . Fshesë për mini lopatë për pastrimin e rrugëve kërkojmë që të largohet kjo kërkesë pasi që është specifike dhe e panevojshme si paisje dhe është kërkesë diskriminuese pasi që vetëm emërtimi tregon që është paisje që dikujt i shkruan në DUD ky emërtim dhe është e panevojshme, pse të mos jetë fshesë për asfalt e cila montohet në qdo paisje po specifikisht për minilopatë.



### **Pretendimi Ankimor 3:**

**Kërkesa 6.2-** OE duhet të ketë bazë për prodhimin e asfaltit në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt dhe të dëshmoj se baza për prodhimin e asfaltit i ka certifikatat e përditesuara dhe të jetë i certifikuar me CE në bazë të licencës konform standardit EN 13108, dhe EN 12697 për prodhimin e asfaltit AB11,BZH22

**Dëshmia 6.2 - Kopja e Lejes per aktivitetet veçant e lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale.** Ne rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, OE duhet te dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim e noterizuar si dhe certifikata per prodhim te asfaltit e noterizuar para njoftimit per kontrat

Kjo kërkesë është favorizim absolut i një kompanie të caktuar pasi që sipas hulumtimit të tregut që kemi bërë dhe hulumtimit në shumë institucione certifikuese me certifikata CE , si bazë e asfaltit me këto certifikata është vetëm një kompani në Kosovë dhe poashtu në rajon.

Andaj kërkesa e tillë kufizon konkurrencën në vetëm një ofertuese ose thënë më mirë nuk ka konkurrencë fare, Pasi që asfalti si pozicion që është pozicion minoren në krahasim me punët tjera të kontratës është edhe specifik dhe nuk mund të transportohet nga vende të largëta dhe kësaj kërkese pamundësojnë ofertimin në këtë procedurë.

Poashtu nëse përdorim logjikën ju si AK- do të duhej të kërkonit specifika për shumë pozicione tjera që janë më specifike për shtëpitë e kulturës përshebull pozicionet e fasadave , dyshemeve , instalimeve elektrike dhe HVAC , por ju si AK me qëllim që të zvogloni konkurrencën keni vendosur kërkesa diskriminuese, ku supozjmë se jeni të njoftuar se vetëm një kompani e prodhimit të asfaltit posedon këto certifikata.

Kërkojmë nga ju që të largohen këto certifikata pasi që këto mbysin konkurrencën e lirë dhe janë skajshmërisht diskriminuese.

Si përfundim keni bërë konceptim të kërkesave që janë tipike për ndërtim të ulët në një kontratë që është ndërtim i lartë, përveq kësaj paisjet e kërkuara po besojmë do të mjaftonin për të kryer punime në një Autostradë e ju i keni kërkuar për një Oborr 650 m<sup>2</sup> . Kërkojmë nga ju si AK-së ti largoni këto kërkesa diskriminuese dhe favorizuese dhe të mundësoni aplikimin e gjërë të kompanive që janë të specializuara për punë të ndërtimit të lartë ashtu edhe siq është lloji i kontratës.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;

që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i janë përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoritet kontraktues nuk i kanë respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe

të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu autoritet kontraktues nuk i kam respektuar edhe dispozitat e nenit 59 të LPP-së, pasi nuk kanë bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në mënyrë të drejtë, në mënyrë të njëjtte dhe në mënyrë të barabart.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Ankesën tonë në mënyrë meritore dhe të nxjerrni:

### **VENDIM**

**APROVOHET**, Kërkesa për rishqyrtim e OE "HARST Group" Sh.p.k.

**NDRYSHOHEN DHE PËRMIRSOHEN KËRKESAT TEKNIKE PROFESIONAL,**

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, për të gjitha shkeljet ligjore që supozojmë kanë ndodhur në këtë procedurë tenderuese.

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Ne konsiderojmë që AK na ka bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim .

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*